

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË – DEGA NË PODUJEVË - Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil** : me gjyqtarin Bujar Muzaqi, dhe sekretaren juridike Afërdita Ejupi, në çështjen juridiko civile të Paditëses Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Rrugën “...” Objekti Ilamela A, Komuna e Prishtinës, të cilën me autorizim e përfaqëson L.B. me autorizim në shkresat e lëndës, kundër të Paditurit A.H. dikur me vendbanim në Rrugën “...”, Komuna e P., tani me vendbanim të panjohur, të cilin e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm Avokat B.Sh. me seli në P., në çështjen kontestimore për kthimin e mjeteve të paguara, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditëses, dhe të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, me datë 21.09.2018 morri këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET NË TËRËSI** kërkesëpadia e paditëses Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” me seli në Rrugën “...” Objekti Ilamela A, Komuna e Prishtinës, **SI E BAZUAR.**

**II. DETYROHET** i padituri A.H. dikur me vendbanim në Rrugën “...”, Komuna e P., tani me vendbanim të panjohur, që në emër të kthimit të mjeteve të paguara nga paditësja, t’ia paguaj paditëses shumën prej 1246 Euro, me kamatë vjetore siç e paguajnë Bankat afariste në Republikën e Kosovës kursimtarëve të vet në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar nga data e mbajtjes së shqyrtimit kryesor të dt 21.09.2018 e deri në pagesën definitive, e të gjitha në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

**III. DETYROHET** i padituri A.H. dikur me vendbanim në Rrugën “...”, Komuna e P., tani me vendbanim të panjohur, që t’ia paguaj paditëses Kompania e Sigurimeve “SIGURIA” shumën prej 135 Euro në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Paditësja Kompania e Sigurimeve “SIGURIA”, me seli në Rrugën “...” Objekti Ilamela A, Komuna e Prishtinës, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurit A.H. dikur me vendbanim në Rrugën “...”, Komuna e P., tani me vendbanim të panjohur, përmes së cilës ka theksuar se me datën 09.07.2002, Gjykata Komunale me aktgjykim C.nr.1221/2001 ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit A.H. Kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale paditësi atëherë i padituri KS “SIGURIA”, ka paraqitur ankesë Gjykatës se Qarkut në Prishtinë. Gjykata e Qarkut me aktgjykim Ac.nr.189/2003

datë 16.10.2003 refuzon ankesën e paditësit-tani të paditurit dhe e vërteton aktgjykimin e shkallës së parë, po ashtu në padi ndër të tjera ka deklaruar se "...Gjykata supreme me aktgjykim nr Rev 150/2003 pranon revizionin e paditësit atëherë të paditurit KS "SIGURIA", ndryshon aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.189/2003 datë 16.10.2003 dhe Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1221/2001 datë 09.07.2002, refuzon si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit tash të paditurit A.H...."

Në seancën e shqyrtimit kryesor e në fjalën përfundimtare të mbajtur me datë 21.09.2018 i autorizuari i paditëses ndër të tjera ka deklaruar se "...mbesim në tërësi pranë padis dhe kërkesëpadisë duke precizuar kërkesëpadinë në shumën prej 1246Euro, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 135Euro. Propozoj Gjykatës që në tërësi ta aprovoj kërkesëpadinë për kthimin e mjeteve të paguara për arsye se i njëjti është kompensuar pa baze ligjore ku këtë e ka vërtetuar Gjykata Supreme në arsyetimin e lartcekur, ndërsa në tersi i kundërshtojmë deklaratimet e përfaqësuesit të përkohshëm se nuk ka baze ligjore kërkesëpadia, dhe nuk kemi të bëjmë me kontribut dhe as me dispozitën e LMD-së pika 1 e nenit 199 pasi që kjo dispozitë ligjore ka të bëjë për personat të cilët lëndohen dhe kompensimi i dëmit bëhet në emër të dëmit jo material, e në rastin konkret kemi të bëjmë me një dëm material i cili është kompensuar detyrimisht nga pala paditëse pa pasur bazë ligjore, pasi që i njëjti nuk ka pasur patentë shofer dhe ka pasur të humbur mbulesën siguruese kjo ka qenë e rregulluar me udhëzimin administrativ neni 1.5 të cilën e ka arsyetuar Gjykata Supreme, andaj mbes në tersi pranë padisë dhe kërkesëpadisë...".

Në seancën e shqyrtimit kryesor e në fjalën përfundimtare të mbajtur me datë 21.09.2018 përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit ndër të tjera ka deklaruar se "... edhe njëherë deklaroj se mbetemi në tërësi pranë përgjigjeve në padi të ushtuar pranë kësaj Gjykate e Kundërshtoj padinë e paditësit në tërësi si të pa bazuar, konsiderojmë se paditësi nuk ka bazë ligjore për objektin e padisë, nga se i padituri ka qenë dëmtuar në aksidentin e komunikacionit të datës 18.10.2001 në Fshatin Konushëfc, dhe këtë e ka vërtetuar edhe Gjykata e shkalles së parë mbështetur në mendimin e ekspertit se deri të aksidenti ka ardhur ekskluzivisht me fajin e të sigurvearit të paditësit, në anën e të paditurit nuk kanë ekzistuar lëshime dhe me as një veprim nuk ka kontribuar në shkaktimin e aksidentit, edhe si të ekzistonte një e drejtë për paditësin në rastin konkret në neni 199.1 të LMD-së. Si dhe shpenzimet sipas tarifës së TOA-së, shpenzimet i kërkoj në shumë prej 135Euro për seancën e sotit, dhe pagesa të më bëhet sipas xhirollogarisë me nr. 1709001012925127 në NLB bankë, kërkoj që të refuzohet në tërësi padia e paditëses si e pa bazuar...".

Në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 21.09.2018 u administruan provat për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike siç janë : Aktgjykimin i Gjykatës Komunale në Prishtinë me numër C.nr.1221/2001 dt.09.07.2002, Aktgjykimin i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë me numër Ac.nr.189/2003 dt.09.07.2002, Urdhëresë Transferi e lëshuar nga Banka Ekonomike dt.10.11.2003, Aktgjykimin i Gjykatës Supreme në Prishtinë me numër Rev. nr.150/2003 dt.23.05.2004.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndërgjegje të secilës provë veç e veç dhe të gjithave bashkërisht e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, kjo Gjykatë lidhur me këtë çështje kontestimore juridiko – civile vërtetoi se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Pas administrimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykata vërtetoi gjendjen faktike si vijon:

– Në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1221/2001 dt.09.07.2002, dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë Ac.nr.189/2003 dt.16.10.2003, si dhe nga urdhëresa e Transferit e lëshuar nga Banka Ekonomike dt.10.11.2003 vërtetohet se e paditura e ka bërë pagesën e shumës në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës së shkallës së parë i cili fakt nuk është kontestues.

Po ashtu nuk është kontestuese se në bazë të Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.150/2003 dt.23.05.2004 në të cilin Aktgjykim ndër të tjera thuhet se *“...PRANOHET revizioni i të paditurës dhe NDRYSHOHEN Aktgjykimi i Gjykatës që Qarkut në Prishtinë, Ac.nr.189/2003 datë 16.10.2013 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale Prishtinë, C.nr.1221/2001 datë 9.7.2002, ashtu që të Refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.H. nga Podujeva, që të detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria” në Prishtinë, që t’i paguaj paditësit në emër të shpërblimit të dëmit material, të shkaktuar më datë 18.10.2001 në automjetin e udhëtarëve “Pezho 405” me targë targat..., shumën prej 1.246.38€uro, në afat prej 15 ditësh nga plotëfuqishmëria e aktgjykimit, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 520€uro...”*, andaj duke u bazuar në këtë Aktgjykim të Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.150/2003, si dhe në dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD), gjegjësisht nenin 17 të këtij ligji ku ndër të tjera thuhet se *“...pjesëmarrësit e marrëdhënies së detyrimit kanë për detyrë që ta zbatojnë detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij...”*, po ashtu në nenin 262 të po këtij ligji, ndër të tjera thuhet se *“...kreditori në raportin e obliguar është i autorizuar që prej debitorit të kërkojë mbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta mbushë me ndërgjegje krejtësisht sikundër është përmbajtja e tij...”*, u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Kamata iu llogarit nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit dt 10.09.2018, kur u vërtetua borxhi e deri në pagesën përfundimtare konform nenit 277 të Ligjit nr.3/3/1978 mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve si ligj në fuqi kur është krijuar raporti detyrimor.

Sa i përket pretendimeve të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit thënë në seancën e dt.21.09.2018, se kjo e drejtë nuk mund të realizohet duke u bazuar në nenin 199.1 të LMD, Gjykata sa i përket këtij pretendimi të përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit vlerësoi se ky nen ka të bëjë vetëm me kompensimin e dëmit jo material, e në

këtë procedurë kontestimore kemi të bëjmë me kompensimin e dëmit material gjegjësisht kompensimin e dëmit material të vetures të shkaktuar nga aksidenti i dt.18.10.2001.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore Gjykata u bazua në nenin 452 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore dhe atë për shpenzimet e përfaqësimit ne seancë gjyqësore në shumën 135 Euro, pasi që vetëm këtë shpenzim e ka kërkuar Paditësja.

Nga të lartëcekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e konform nenit 143 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEGA NË PODUJEVË**  
**Departamenti i përgjithshëm – divizioni civil**  
**C.nr.197/04 datë 21.09.2018**

**Gjyqtari,**  
**Bujar Muzaqi**

**KËSHILLA JURIDIKE** : Kundër këtij Aktgjykimi lejohet ankesa në afatin prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë e nëpërmes kësaj Gjykate.